



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKQYRJES PUBLIKE

PROGRAMI I PUNES SE
BORDIT TE MBIKQYRJES PUBLIKE PER VITIN 2013

I. Prioritetet për aktivitetin e Bordit të Mbikqyrjes Publike (BMP) për vitin 2013:

1. Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet e organizuara nga IFIAR;
2. Planifikimi dhe kryerja e aktiviteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative;
3. Angazhimi në projektin e Bankës Botërore - CFREP-Albania;
4. Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 të organizuara nga AC-ja.

II. Implementimi i prioriteteve

1. Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet te brendshme si edhe ato të organizuara nga IFIAR

Objektivi kryesor: Bashkëpunimi institucional me rregullatoret vendas si dhe me IFIAR dhe përfitimi i përvojës dhe njohurive të organizatave të ngjashme ndërkombëtare.

2. Planifikimi dhe kryerja e aktiviteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative;

Objektivi kryesor: Planifikimi dhe zbatimi i planit të kontrollit nga kontrollorët e BMP-s për auditimet e shoqërive me interes publik për PF të vitit 2012. Përmirësimi i metodologjisë dhe njohurive që duhet të zotërojnë kontrollorët e BMP-s në kryerjen e misionit të kontrollit të cilësisë së auditimit të shoqërive me interes publik.

Rishikimi i planit të kontrollit të kryer nga IEKA për auditimet e PF të vitit 2012 dhe rishikimi i rezultateve të kontrollit. Investigimi i cdo informacioni që ka të bëjë me cilësinë në punën e EKR-ve. Miratimi i vendimeve për masa disiplinore që vijnë nga IEKA.

3. Angazhimi në projektin e Bankës Botërore - CFREP-Albania për komponentin që ka lidhje me mbikqyrjen publike.

Objektivi kryesor: Bashkëpunimi me asistentët e këtij projekti dhe kontributi në përmirësimin e legjislacionit dhe rregulloreve që kanë lidhje me komponentin e BMP-s.

4. Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 të organizuara nga AC-ja;

Objektivi kryesor: Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 për zbatimin e rregullores dhe procedurave të testimit.

Nr.	AKTIVITETET	PERSONAT PËRGJEGJËS	PERIUDHA
1. Angazhimi institucional i BMP-s në aktivitetet e brendshme si edhe ato të organizuara nga IFIAR			
1.1	Pjesëmarrje në workshop për kontrollin e cilësisë në Forumin Ndërkombëtar të Mbikqyrsave Publik (IFIAR).	Elton Haxhi	Shkurt 2013
1.2	Takim me BSH dhe AMF dhe shkëmbim informacioni për çështjet e raportimit financiar dhe auditimit të insitucioneve financiare.	BMP	Prill 2013
2. Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve mbikqyrëse, monitoruese dhe investigative;			
2.1	Organizimi dhe realizimi i mbikqyrjes së organizatave profesionale për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.	BMP	Në vazhdimësi
	2.1.1. Rishikimin e aktivitetit të Komisionit të Kontrollit të Cilësisë dhe rezultatet e raportit për vitin 2012;	BMP	Mars 2013
	2.1.2. Rishikimin e aktivitetit të Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës dhe rezultatet e raportit për vitin 2012;	BMP	Mars 2013
	2.1.3. Shqyrtimi i raporteve të organizatave profesionale të kontabilitetit për veprimtarine e tyre gjatë vitit 2012.	BMP	Korrik 2013
2.2	Përmirësimi i manualit të kontrollit	BMP, Konsulenti	Korrik 2013
2.3	Përzgjedhja e inspektorëve për kontrollin 2012 dhe trainimi i tyre	BMP	Korrik 2013
2.4	Planifikimi dhe realizimi i misioneve të kontrollit të profesioneve kontabile (të EKR-ve si edhe shoqërive të auditimit) për rritjen e sigurisë, për një ambjent transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm në shërbim të interesit publik.	BMP	Si më poshtë
	2.2.1. Planifikimi i kontrolli për cilësinë e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2012.	BMP, Inspektorët	Shtator 2013
	2.2.2. Miratimi i rezultateve të kontrollit 2012	BMP	Nëntor 2013
2.5	Pranimi, shqyrtimi dhe marrja e vendimeve përkatëse lidhur me ankesat e bëra për rastet që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë profesionet kontabël.	BMP	Në vazhdimësi

3. Angazhimi në projektin e Bankës Botërore - CFREP-Albania për komponentin që ka lidhje me mbikqyrjen publike.

3.1	Bashkëpunimi me asistentët e këtij projekti dhe kontributi në përmirësimin e legjislacionit dhe rregulloreve që kanë lidhje me komponentin e BMP-s.	BMP	Në vazhdimësi
-----	---	-----	---------------

4. Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 të organizuara nga AC-ja;

4.1	Mbikqyrja e procesit të provimeve për vitin 2013 për zbatimin e rregullores dhe procedurave të testimit.	BMP	Maj-Qershor 2013
4.2	Miratimi rezultatit 2013 dhe i buxhetit për vitin 2014	BMP, IEKA, AC	Dhjetor 2013